NJOFTIM STATUTOR

PROPOZIM PËR MBYLLJEN E SHKOLLËS FILLORE TIVERTON, PULFORD ROAD, LONDON N15 6SP DFE NR. 309/2057

Njoftimi po jepet në përputhje me Seksionin 15 (1) të Ligjit për Arsimin dhe Inspektimet 2006 (i ndryshuar me Ligjin për Arsimin 2011) dhe Rregulloret për Organizimin e Shkollave 2013 (Krijimi dhe Mbyllja e Shkollave), se Këshilli i Haringey propozon të mbyllë Shkollën Fillore Tiverton, Pulford Road, London N15 6SP me efekt nga data **31 Gusht 2025.**

Më 11 Shkurt 2025, Kabineti i Këshillit ra dakord të procedojë me publikimin e këtij propozimi ligjor për mbylljen e shkollës si rezultat i uljes së konsiderueshme të numrit të nxënësve në shkollë.
Ky vendim u pasua nga një konsultim joformal mbi propozimet, i cili u zhvillua nga data 6 Nëntor 2024 deri më 18 Dhjetor 2024.

Më pak fëmijë të regjistruar, do të thotë më pak financim nga qeveria për funksionimin e shkollave, gjë që me kalimin e kohës krijon presione të konsiderueshme financiare. Lidhja ndërmjet numrit të nxënësve dhe financimit të shkollës do të thotë se nuk është gjithmonë e mundur të mbahet një shkollë në funksionim për të garantuar standardin e arsimit që familjet dhe nxënësit meritojnë. Nëse merret vendim për mbylljen e Shkollës Fillore Tiverton, të gjithë fëmijët që ndjekin shkollën do të mbështeten për të gjetur vende në shkolla të tjera, në përputhje me preferencat e prindërve dhe/ose disponueshmërinë e vendeve brenda zonës duke filluar nga Shtatori 2025.

Brenda katër javëve nga data e publikimit të këtij njoftimi, çdo person mund të kundërshtojë ose të bëjë komente mbi propozimin:

a) Nëpërmjet email-it në adresën: schoolconsultation@haringey.gov.uk duke dërguar kundërshtime, komente ose pyetje
ose
b) Me letër në adresën: School Admissions, 5th Floor, Haringey Council, 48 Station Road, London N22 7TY.

Përgjigjet duhet të dorëzohen deri në orën **17:00 më 24 Mars 2025**, kur ky njoftim ligjor dhe periudha e përfaqësimit do të skadojnë. Në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2, Paragrafi 18 i Ligjit për Arsimin dhe Inspektimin 2006 (i ndryshuar me Ligjin për Arsimin 2011), duhet të merret një vendim nga vendimmarrësi jo më vonë se dy muaj pas skadimit të periudhës së përfaqësimit. Prandaj, Kabineti i Këshillit të Haringey duhet të marrë një vendim mbi këtë propozim deri më **19 Maj 2025** (në varësi të një periudhe njoftimi prej 5 ditësh); përndryshe, duhet ta referojë vendimin tek Gjykuesi për Shkollat.

Ky Njoftim është një ekstrakt nga propozimi i plotë. Kopjet e propozimit të plotë mund t'i gjeni në adresën: https://tivertonprimary.commonplace.is

Nëse keni nevojë për një kopje në letër të këtij propozimi, ju lutemi na kontaktoni nëpërmjet postës elektronike në adresën: schoolconsultation@haringey.gov.uk

Ky dokument është përkthyer në gjuhët e mëposhtme: Shqip, Portugalisht, Somaleze, Spanjisht dhe Turqisht. Këto janë gjuhët që nevojiten për t'u siguruar akses familjeve, për të cilat Anglishtja është një gjuhë shtesë, siç është identifikuar gjatë periudhës së mëparshme

të konsultimit. Versionet e përkthyera gjenden në adresën: https://tivertonprimary.commonplace.is

Nëse keni nevojë që ky dokument të përkthehet në një gjuhë tjetër, ju lutemi na kontaktoni sa më shpejt të jetë e mundur duke na dërguar email në adresën: schoolconsultation@haringey.gov.uk



Jane Edwards
Ndihmës Drejtor për Shkollat dhe Mësimin

24 SHKURT 2025

PROPOZIM LIGJOR PËR MBYLLJEN E SHKOLLËS FILLORE TIVERTON

TË DHËNAT E KONTAKTIT:

1. **Propozuesi:**
   Këshilli i Haringey, 5th Floor, 48 Station Road, London N22 7TY Faqja e Internetit: www.haringey.gov.uk

2. **Shkolla:**
   Shkolla Fillore Tiverton, Pulford Road, London N15 6SP Telefon: 020 8800 3779
   Email: office@tiverton.haringey.sch.uk

3. **Kategoria e shkollës:**
   Shkolla Fillore Tiverton është një shkollë komunitetit e cila financohet nga Autoriteti Vendor Haringey.

ZBATIMI:

Data e planifikuar për mbylljen e Shkollës Fillore Tiverton është 31 Gusht 2025.

ARSYEJA E MBYLLJES:

Faktorët kryesorë që çojnë në mbylljen e propozuar janë numri i ulët dhe në rënie i nxënësve, gjë që ndikon në qëndrueshmërinë financiare të shkollës dhe, rrjedhimisht, në aftësinë për të ofruar arsim me cilësi të lartë për nxënësit. Numri i nxënësve në Shkollën Fillore Tiverton ka rënë vazhdimisht gjatë viteve të fundit. Duke qenë se buxhetet e shkollave bazohen në numrin e nxënësve në shkollë, ka një presion financiar në rritje mbi financat e shkollës, i cili pritet të përkeqësohet nëse Shkolla Fillore Tiverton mbetet e hapur. Në fund të vitit financiar 2024/2025, pritet që shkolla të ketë një deficit prej 704 mijë paundësh, i cili do të rritet në më shumë se 1.3 milion paund deri në fund të vitit financiar 2025/2026.

Ne jemi konsultuar mbi opsionet për të ardhmen e Shkollës Fillore Tiverton, por megjithatë, për shkak të rënies së vazhdueshme të numrit të nxënësve, nuk mendojmë se planet afatshkurtra ose afatmesme për të rikuperuar deficitin janë të arritshme. Për më tepër, numri i ulët i nxënësve ndikon edhe në përvojën shkollore për nxënësit, pasi ka më pak mundësi për aktivitete pasuruese dhe më pak personel për të ofruar një program mësimor cilësor, që meritojnë nxënësit.

Këshilli është përgjegjës për të siguruar që fëmijët në shkollat e tij të marrin një arsim të mirë dhe të kenë akses në një program mësimor të plotë. Një shkollë me një numër në rënie të nxënësve do ta ketë të vështirë ta bëjë këtë në mënyrë efektive për shkak të presioneve të pashmangshme financiare që vijnë nga reduktimi i financimit. Lidhja ndërmjet numrit të nxënësve dhe financimit të shkollës do të thotë se nuk është gjithmonë e mundur të mbahet një shkollë në funksionim për të garantuar standardin e arsimit që familjet dhe nxënësit meritojnë. Prandaj, mbajtja e Shkollës Fillore Tiverton hapur, ka të ngjarë të dëmtojë arsimimin e nxënësve të regjistruar dhe të zgjasë periudhën e pasigurisë që rrethon të

ardhmen e shkollës. Si rezultat, mbyllja e shkollës është opsioni më i mirë për të shmangur çdo dëm të mëtejshëm në edukimin e fëmijëve.

NUMRAT E NXËNËSVE DHE REGJISTRIMET

Pavarësisht përpjekjeve të gjera të shkollës për të tërhequr më shumë familje, Shkolla Fillore Tiverton nuk ka parë asnjë përmirësim në numrin e familjeve që aplikojnë për këtë shkollë. Nga Tetori 2019 deri në Tetor 2024, numri total i nxënësve të regjistruar në shkollë u zvogëlua me gati gjysmën, duke rënë nga 310 në 152 (shikoni Figurën 1 më poshtë).

Në Janar 2025, të dhënat për regjistrimin e nxënësve nga shkolla tregojnë se numri i nxënësve të regjistruar aktualisht ka rënë më tej në 122 nxënës (nga Klasa Përgatitore deri në Klasën e 6-të). Kjo rënie e vazhdueshme e numrit të nxënësve ka rezultuar në një humbje të konsiderueshme të financimit bazë vit pas viti. Në vitin akademik 2024/25, për çdo vend të tepërt që ka një shkollë fillore e financuar, do të ketë një humbje prej 4025 £ mesatarisht, financimi i njësisë së nxënësve sipas moshës (AWPU) për nxënës.

Duke qenë se numri aktual i nxënësve të regjistruar është dukshëm më i ulët se numri i pritshëm për një shkollë fillore me një paralele, e cila ka kapacitet për 210 nxënës nga klasa Përgatitore deri në klasën e 6të, shkolla nuk konsiderohet financiarisht e qëndrueshme për të vazhduar funksionimin. Figura 1 më poshtë tregon numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në shkollë ndërmjet Tetorit 2019 dhe Tetorit 2024, ndërsa Figura 2 tregon numrin e nxënësve të regjistruar në çdo grupmoshë sipas censusit të Tetorit 2024.

Figura 1: Numri i Përgjithshëm i nxënësve të regjistruar - të dhënat e censusit të shkollës në Tetor

Shkolla	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Tiverton Primary	310	354	301	271	241	152

Figura 2: Numri i nxënësve të Tiverton sipas grupeve të klasave – sipas regjistrimit të tetorit 2024

Shkolla	Klasa Përgatitore	Klasa e 1-rë	Klasa e 2-të	Klasa e 3-të	Klasa e 4-të	Klasa e 5-të	Klasa e 6-të
Numri i nxënësve	20	22	14	16	24	26	30

Figura 3 më poshtë tregon shpërndarjen gjinore dhe numrin e fëmijëve me një Plan për Arsimin, Shëndetin dhe Kujdesin (EHC) të regjistruar në shkollë sipas censusit të Tetorit 2024. Procesi i konsultimit për shkollat alternative për fëmijët me Planin EHC ka filluar në përputhje me procesin ligjor të SEND për të siguruar që këta fëmijë të mos preken nga propozimi për mbylljen e shkollës, nëse ai zbatohet.

Figura 3: Karakteristikat gjinore dhe të SEN të nxënësve që janë regjistruar sipas Grup-Moshave deri në Tetor 2024 sipas censusit të shkollës

Tetor 2024	Mashkull	Femër	MBËSHTETJE PËR SEN	EHCP
Klasë Përgatitore	7	13		2
Klasa e 1-rë	10	12	2	
Klasa e 2-të	6	8	2	3

Klasa e 3-të	13	3	1	1
Klasa e 4-të	11	13	1	3
Klasa e 5-të	10	16		2
Klasa e 6-të	10	20	4	1
Regjistrimi Total	**67**	**85**	**10**	**12**

NXËNËSIT E ZHVENDOSUR

Sipas regjistrimit të Tetorit 2024, kishte 152 nxënës të regjistruar nga Klasa Përgatitore deri në Klasën e 6-të. Që nga fillimi i procesit të konsultimit joformal të Fazës 1 në Nëntor 2024, disa familje kanë bërë aplikime gjatë vitit shkollor për të transferuar fëmijët e tyre në shkolla të tjera. Në Janar 2025, të dhënat nga regjistrat e shkollës tregojnë se 122 nxënës nga Klasa Përgatitore deri në Klasën e 6-të vazhdojnë të jenë të regjistruar në shkollë. Meqenëse mbyllja e shkollës nuk do të prekë fëmijët në Klasën e 6-të, pasi ata do të transferohen në shkollën e mesme në Shtator 2025, më së shumti, 93 nxënës pritet të preken nga një vendim për mbylljen e shkollës në Gusht 2025.

Aktualisht nuk ka fëmijë në çerdhe që ndjekin shkollën. Në zonën lokale ka mjaft institucione alternative për çerdhe, me 11 shkolla fillore në Haringey brenda 1 milje nga Shkolla Fillore Tiverton. Ekziston edhe një çerdhe e financuar nga Haringey (Shkolla dhe Qendra e Fëmijëve në Woodlands Park), e cila ndodhet 0,6 milje larg shkollës.

Figura 4 më poshtë tregon numrin e vendeve të disponueshme në shkollat në Haringey brenda një distance prej 1 milje nga Shkolla Fillore Tiverton që nga Dhjetori 2024. Ndërkohë që këto numra mund të kenë ndryshuar për shkak të lëvizjes së nxënësve, aktualisht ka më shumë se mjaftueshëm vende të lira në të gjitha grup-moshat në 14 shkollat e Haringey brenda 1 milje nga shkolla. Kjo dëshmon se ka kapacitet të mjaftueshëm rezervë në shkollat lokale për të akomoduar fëmijët të cilët ka të ngjarë të zhvendosen nëse zbatohet vendimi për mbylljen e Shkollës Fillore Tiverton.

Figura 4 - Vendet e lira në shkollat lokale në Haringey, brenda një distance me këmbë prej 1 milje nga Shkolla Fillore Tiverton, sipas të dhënave në regjistrat e shkollës deri në Dhjetor 2024

SHKOLLA	ZONA E PLANIFIKIMIT	METRIKË	Klasa 0	Klasa e 1-rë	Klasa e 2-të	Klasa e 3-të	Klasa e 4-të	Klasa e 5-të	Klasa e 6-të
Shkolla Fillore Chestnuts	PA3	Vende të lira			3	1			2
Shkolla Fillore Crowland	PA3	Vende të lira	9			10	4		10
Shkolla Fillore Seven Sisters	PA3	Vende të lira		2	31	1		29	
Shkolla Parashkollore South Harringay	PA3	Vende të lira		5					

Shkollë për Fëmijët nga mosha 7 - 11 vjeç South Harringay	PA3	Vende të lira				1		1	17
Shkolla Fillore St Ann's CE	PA3	Vende të lira		5	5	5	5		10
Shkolla Fillore Katolike St Ignatius	PA3	Vende të lira	2	13	7	6			9
Shkolla Fillore Katolike St John Vianney	PA3	Vende të lira			1		3	1	3
Shkolla Katolike Parashkollore St Mary	PA3	Vende të lira	7		2				
Shkolla Katolike për Fëmijët nga mosha 7 - 11 vjeç St Mary	PA3	Vende të lira				22	15	2	25
Shkolla Fillore West Green	PA3	Vende të lira					1		
Shkolla Fillore Earlsmead	PA4	Vende të lira	11	9				2	1
Akademia Fillore Harris Philip Lane	PA5	Vende të lira			1	5	4		8
Shkolla Fillore North Harringay	PA5	Vende të lira		15	1		6	11	3
		Vende të Lira në Total	**29**	**49**	**51**	**51**	**38**	**46**	**88**
Shkolla Fillore Tiverton	**PA3**	**Fëmijët e Regjistruar**	**17**	**18**	**11**	**13**	**18**	**21**	**29**
		Pjesa e mbetur	12	31	40	38	20	25	59

NDIKIMI NË KOMUNITET

Të dhënat në Figurën 4 më sipër tregojnë se duke pasur parasysh disponueshmërinë e vendeve të lira në shkollat lokale, ndikimi i mbylljes së Shkollës Fillore Tiverton në komunitet do të jetë i kufizuar. Të gjitha shkollat në zonën lokale janë vlerësuar nga Ofsted si "E Mirë" ose "E Shkëlqyer". Ne do të përpiqemi të plotësojmë preferencat e prindërve për vendet në shkollë, sa të jetë e mundur.

Për më tepër, mbyllja e Shkollës Fillore Tiverton do të ulte numrin e vendeve të tepërta në shkollat fillore në Zonën e Planifikimit (3) dhe në të gjithë njësinë bashkiake. Këshilli vlerëson se lejimi i tepricës së vendeve mbi 10% nëpërmjet mosveprimit do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe negativ në qëndrueshmërinë financiare të shkollave të tjera në Haringey, gjë që nga ana tjetër do të ndikojë në cilësinë dhe shtrirjen e arsimit të ofruar në ato shkolla.

Shkolla ofron përdorimin e kabinave portative për një bamirësi lokale e cila operon një bankë ushqimi dhe program kadetësh në vend, megjithatë, mjedise të përshtatshme alternative mund të sigurohen në vende të tjera afër. Këshilli mund të mbështesë shoqatën bamirëse për të gjetur një vend tjetër të përshtatshëm ose për të vazhduar veprimtarinë në vend nëse zbatohet mbyllja e shkollës. Nuk do të ketë humbje të klubeve ose programeve pasuruese për familjet lokale në komunitet.

Në bashkëpunim me shkolla të tjera në njësinë bashkiake, po merren masa për të lehtësuar rishpërndarjen e personelit (kur është e mundur dhe e përshtatshme), i cili mund të zhvendoset në rast të mbylljes së shkollës në vende të tjera në Haringey ku ekzistojnë vende të lira pune. Kur rivendosja nuk është e mundur, do të ofrohet mbështetja e duhur individuale për të kufizuar ndikimin e mbylljes tek personeli i prekur. Gjithashtu, do të zhvillohen konsultime me Sindikatat dhe shoqatat profesionale përkatëse, me të cilat do të mbahen kontakte të rregullta gjatë gjithë procesit të mbylljes, nëse bihet dakord për mbylljen.

Ekuilibri i Edukimit Fetar

Shkolla nuk ka status fetar. Mbyllja e propozuar nuk do të ndikojë në numrin e shkollave fillore brenda Haringey me status fetar. Në Zonën e Planifikimit 3 (PA3), ku ndodhet Shkolla Fillore Tiverton, do të vazhdojnë të funksionojnë 4 shkolla me status fetar (1 Kisha e Anglisë dhe 3 Katolike Romake). Numri i shkollave fillore jo-fetare do të ulet me 1.

UDHËTIMI

Harta dhe analiza e të dhënave për fëmijët sipas kodit postar në Shkollën Fillore Tiverton, tregon se shumica e familjeve jetojnë në zonën lokale, ndërsa një numër i vogël jetojnë jashtë Haringey në lagjet fqinje si Hackney. Javën që filloi më 27 janar 2025, në Shkollën Fillore Tiverton ishin 122 fëmijë të regjistruar nga Klasa Përgatitore deri në Klasën e 6-të (të dhënat nga regjistrat të dorëzuara nga shkolla). Tiverton është shkolla më e afërt në Haringey për 42% (51 fëmijë). Megjithatë, vetëm 105 nga këta fëmijë janë banorë të Haringey. 17 fëmijët e mbetur jetojnë në njësitë bashkiake fqinje dhe do t'u caktohen vende në njësitë e tyre bashkiake, të cilat mund të jenë gjeografikisht më afër shtëpisë së tyre. Ka shumë të ngjarë që këto familje të kenë disa shkolla alternative brenda distancës në këmbë, e cila është caktuar me ligj, nga shtëpitë e tyre (d.m.th. dy milje për fëmijët nën moshën tetë vjeç dhe tre milje për nxënësit e moshës 8-16 vjeç).
Shkolla Fillore Tiverton është shkolla më e afërt për vetëm një të tretën e nxënësve që janë regjistruar aktualisht (42 fëmijë). Duke marrë parasysh vetëm banorët e Haringey (pranohet se ata që nuk janë banorë të Haringey, do të vendosen në shkolla në njësitë e tyre bashkiake):

- Distanca mesatare e udhëtimit aktualisht në Tiverton është 0.3731 milje.
- 59% jetojnë më afër një shkolle tjetër në Haringey.
- Nëse të gjithëve do t'u ofroheshin vende në shkollën alternative më të afërt në Haringey, distanca mesatare e udhëtimit për këtë grup nxënësish do të ishte vetëm 0,2006 milje.
- Nëse të gjithëve do t'u ofroheshin vende në shkollën alternative më të afërt në Haringey*, e cila sot ka një vend të lirë në dispozicion*, distanca mesatare e udhëtimit për këtë grup nxënësish do të ishte 0,2142 milje.

Kjo do të thotë se për sa i përket distancës së udhëtimit, banorët e Haringey që aktualisht ndjekin Shkollën Fillore Tiverton do të jenë në një avantazh të lehtë në udhëtimin e tyre të përditshëm për në shkollë, pasi ai do të jetë mesatarisht mbi 0,15 milje më i shkurtër. Prandaj, propozimi për mbylljen e shkollës nuk ka gjasa të çojë në rritje të përdorimit të makinës ose

udhëtime më të gjata për nxënësit e zhvendosur, pasi ata do të udhëtojnë mesatarisht një distancë më të shkurtër nëse u ofrohet shkolla alternative më e afërt në Haringey që ka një vend të lirë.

PROCEDURA PËR BËRJEN E DEKLARATAVE

Brenda katër javëve nga data e publikimit të këtij njoftimi, çdo person mund të kundërshtojë ose të bëjë komente mbi propozimin:

a) Nëpërmjet email-it në adresën: schoolconsultation@harigney.gov.uk duke dërguar kundërshtime, komente ose pyetje
ose
b) Me letër në adresën: School Admissions, 5th Floor, Haringey Council, 48 Station Road, London N22 7TY.

Përgjigjet duhet të dorëzohen deri në orën **17:00 më 24 Mars 2025**, kur ky njoftim ligjor dhe periudha e përfaqësimit do të skadojnë. Në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2, Paragrafi 18 i Ligjit për Arsimin dhe Inspektimin 2006 (i ndryshuar me Ligjin për Arsimin 2011), duhet të merret një vendim nga vendimmarrësi jo më vonë se dy muaj pas skadimit të periudhës së përfaqësimit. Prandaj, Kabineti i Këshillit të Haringey duhet të marrë një vendim mbi këtë propozim deri më **19 Maj 2025** (në varësi të një periudhe njoftimi prej 5 ditësh); përndryshe, duhet ta referojë vendimin tek Gjykuesi për Shkollat. Nëse keni nevojë për një kopje në letër të këtij propozimi, ju lutemi na kontaktoni nëpërmjet postës elektronike në adresën: schoolconsultation@haringey.gov.uk

Ky dokument është përkthyer në gjuhët e mëposhtme: Shqip, Portugalisht, Somaleze, Spanjisht dhe Turqisht. Këto janë gjuhët që nevojiten për t'u siguruar akses familjeve, për të cilat Anglishtja është një gjuhë shtesë, siç është identifikuar gjatë periudhës së mëparshme të konsultimit. Versionet e përkthyera gjenden në adresën: https://tivertonprimary.commonplace.is

Nëse keni nevojë që ky dokument të përkthehet në një gjuhë tjetër, ju lutemi na kontaktoni sa më shpejt të jetë e mundur duke na dërguar email në adresën: schoolconsultation@haringey.gov.uk